



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 20.10.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):
Artikuj mobilimi 39516000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,582,750 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH.

Afatet e lëvrimit: 60 (qjashtëdhjetë) ditë.

Garancia e mallit do të jetë sipas specifikimeve teknike, bashkëngjitur.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.268 e nr.10311 prot., datë 10.09.2025 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025-2027 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Shqytroi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur preventivin dhe specifikimet teknike të hartuara nga grupi i specifikimeve teknike.

I. PËRLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin nr.16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh:

Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Komisioni organizoi punën për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallin, objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

1. Listat e publikuara nga INSTAT, nuk përmbajnë të dhëna mbi çmimet e mallrave që kërkohen të prokurohen.
2. Institucione të tjera zyrtare të njohura, nuk disponojnë publikime lidhur me çfarë kërkohet.
3. Grupi u mbështet në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor i referohet alternativës të renditur si më poshtë:

a) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; në përzgjedhjen e disa firmave respektivisht në 3 kompani: të cilat janë administruar në dosje.

b) në çmimet e kontratave të mëparshme .

Pas shqyrtimit të të dhënave dhe informacionit të mbledhur, mbështetur në rezultatin e sipërnxjerrë, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 1,582,750 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 40 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objektit është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e dokumentit që vërteton se operatori ekonomik i ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 është përcaktuar në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter mbështetet gjithashtu në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 5, pika “c”, sipas të cilit subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike kanë detyrimin të shlyejnë taksat dhe tarifat vendore ndaj njësisë së qeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin, në përputhje me afatet e miratuara nga këshillat bashkiakë përkatës. Ky kriter garanton që operatori ekonomik që merr pjesë në procedurën e prokurimit është një subjekt i rregullt në kuptimin fiskal dhe administrativ, që respekton detyrimet ligjore dhe financiare ndaj autoriteteve vendore. Përmbushja e këtij detyrimi tregon seriozitet, përgjegjshmëri dhe stabilitet financiar të operatorit ekonomik, duke reduktuar rrezikun që një operator me detyrime të papaguara të mos

jetë në gjendje të përmbushë me korrektësi dhe në kohë kontratën e prokurimit publik. Në përputhje me dispozitat e nenit 26 të VKM-së nr. 285/2021, verifikimi i këtij kriteri mund të bëhet nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga administrata tatimore vendore ose përmes vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9 e DST). Kjo formë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të lehtësimit administrativ të procedurave të prokurimit publik, duke i mundësuar operatorit ekonomik të vetëdeklarojë përmbushjen e detyrimeve, ndërkohë që autoriteti kontraktor mban të drejtën e verifikimit të mëtejshëm pranë organeve përkatëse. Për shkak se objekti i kontratës lidhet me furnizimin e mallrave (mobileri), është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të jenë në rregull me detyrimet e tyre fiskale dhe vendore, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti financiar dhe aftësia e tyre për të përmbushur në kohë dhe cilësi kërkesat e autoritetit kontraktor. Një operator me detyrime të papaguara ndaj njësive të qeverisjes vendore mund të konsiderohet me risk të lartë financiar, gjë që do të cenonte zbatimin e kontratës dhe interesin publik. Në përfundim, ky kriter është proporcional, ligjërish i bazuar dhe teknikisht i domosdoshëm, pasi siguron që në procedurë të marrin pjesë vetëm operatorë që janë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe vendore, duke mbrojtur integritetin dhe barazinë në garë të prokurimeve publike.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të kontratës, mbështetet ligjërish në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 55, pika 4, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Këto dispozita parashikojnë se autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga ofertuesit të paraqesin dëshmi për kontrata të ngjashme të realizuara më parë, në mënyrë që të vërtetojë kapacitetin teknik dhe profesional të tyre për zbatimin me sukses të kontratës që është objekt i procedurës së prokurimit. Në rastin

konkret të objektit “FV mobilieri dhe pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, kërkesa për përvojë të mëparshme është tërësisht e justifikuar nga natyra e furnizimit, pasi përfshin elemente që lidhen me prodhimin, montimin dhe instalimin e mobilieve dhe pajisjeve të brendshme që duhet të plotësojnë standarde teknike dhe cilësore për përdorim institucional. Përvoja e mëparshme në furnizime të ngjashme është tregues i aftësisë së operatorit për të menaxhuar sasi të konsiderueshme pajisjesh, për të respektuar afatet e dorëzimit, standardet e cilësisë, si dhe për të garantuar koordinim me ambientet ekzistuese të punës në institucion. Kërkesa që furnizimet e mëparshme të jenë në vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit është vendosur në përputhje të plotë me kufijtë e përcaktuar në nenin 55, pika 4, germa b të VKM nr. 285/2021, e cila përcakton se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë përvojë në një vlerë që nuk tejkalon 50% të fondit limit të kontratës. Vendosja e pragut 20% është një nivel i arsyeshëm dhe proporcional, që siguron verifikimin e përvojës reale pa kufizuar konkurrencën, duke u dhënë mundësi pjesëmarrjeje një game më të gjerë operatorësh ekonomikë që kanë demonstrueshëm kapacitet për furnizime të ngjashme, por që mund të mos kenë përvojë në vlera shumë të larta. Gjithashtu, kërkesa që përvoja të vërtetohet me vërtetime nga ente publike ose fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore për subjektet private, është plotësisht në përputhje me parimin e transparencës dhe verifikueshmërisë, të sanksionuar në nenin 3 të Ligjit nr. 162/2020. Kjo i jep autoritetit kontraktor mundësinë të verifikojë realisht dhe në mënyrë të dokumentuar ekzistencën e furnizimeve të kryera, datat, sasitë dhe vlerat përkatëse, duke shmangur deklaratimet e rreme ose përvojat e pabazuara. Prandaj, kriteri për përvojën e mëparshme është ligjërish i bazuar, teknikisht i domosdoshëm dhe proporcional me qëllimin e prokurimit publik.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues:

a) Në rast se është prodhues i mobilieve të drurit duhet të ketë të punësuar një staf punonjësish minimalisht 3 punonjës- ngarkim shkarkim-1 punëtorë, montim- 1 punonjës, prodhim -1 marangoze të deklaruar, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar më listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi).

b) Në rast se është tregtar i mobilieve të drurit duhet të ketë të punësuar një staf punonjësish minimalisht 3 punonjës- ngarkim shkarkim-1 punëtorë, montim-2 punëtorë. të deklaruar për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar me listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi). Tregtar në këtë rast do të quhen edhe ato operatorë ekonomikë të cilët mund të jenë vetë prodhues për një pjesë të artikujve dhe tregtarë për pjesën e mbetur të artikujve të kërkuar nga AK. Operatori ekonomik duhet të

dorezojë një deklaratë ku të shprehë listën e artikujve që i prodhon vetë dhe artikujt që vetëm i tregton.

Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Nga ana e AK është kërkuar një numër punonjësish prej 3 personash, sepse kontrata nuk është komplekse, me shume artikuj ku kërkohen punonjës të specializuar në procese specifike të prodhimit të mallrave objekt prokurimi. Shume artikuj janë prodhim sipas përmasave të përcaktuara në planet përkatëse të mobilimit që kërkon precision, cilësi dhe shpejtësi në të njëjtën kohë. Të gjithë artikujt janë parashikuar të jenë Furnizim Vendors, pra përveç prodhimit dhe shpërndarjes kemi të përfshirë edhe procesin e montimit që kërkon punonjës të tjerë. Konkretisht analiza në lidhje me numrin e punonjësve për rastin kur operatori është prodhues dhe tregtar paraqitet si më poshtë vijon: Në bazë të përlllogaritjeve, nisur nga sasia e produkteve të kërkuara, nevojitet staf, si më poshtë vijon: Nisur nga vëllimi i mallrave, llogariten Punëtorë ngarkim shkarkimi 1, montim, prodhim - 2 punëtorë Total- 3 punonjës, ndërsa në rastin kur është tregtar mobilieve të drurit minimalisht duhen 3 punonjës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 1(një) mjet transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton, të përshtatshëm për transport mallrash.

Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira. Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

- Mjetet në pronësi të shoqërohen me : a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë: kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi origjinal ose kopje të noterizuara); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- Mjetet me qira të shoqërohen me: a)kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë venddorëzimit të tyre në destinacionin përkatës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Është kërkuar një kamion mallrash me peshe mbi 1.5 ton, i përshtatshëm për transport mallrash për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjetin e nevojshëm për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qenë se kontrata përmban artikuj të ndryshëm të cilët duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre në shkollën e përcaktuar në objekt prokurimi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresën e përcaktuar në grafikun e shpërndarjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Ky kriter është vendosur në përpjesëtim me natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me furnizimin dhe instalimin e mobilieve e pajisjeve në ambientet e brendshme të institucionit. Duke qenë se mobilet nuk janë produkte të gatshme që dorëzohen vetëm në magazinë, por kërkojnë transport të kujdesshëm, montim dhe vendosje sipas projektit të mobilimit, kërkesa për deklaratën e angazhimit siguron që operatori të marrë përgjegjësi të plotë për dorëzimin e produkteve në gjendje funksionale dhe të përdorshme. Kjo shmang rrezikun e dëmtimeve gjatë transportit ose montimit, garanton efikasitet dhe ul kostot shtesë për autoritetin kontraktor.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë

riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe ndërrimin në raste difektesh si dhe deklaratë për cilësinë dhe origjinën e mallrave, objekt i këtij prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor se operatori merr përsipër zëvendësimin e mallrave dhe lëvrimin sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mallrat e ofruar si dhe ndërrimin në rast se nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës. Ky detyrim ka si qëllim të garantojë se mallrat e ofruara janë produkte të reja, funksionale dhe në përputhje me kërkesat teknike të miratuara nga autoriteti kontraktor. Garancia shërben si mekanizëm mbrojtës ndaj defekteve të mundshme pas dorëzimit, duke i detyruar operatorët të mbulojnë me përgjegjësi çdo defekt, riparim apo zëvendësim brenda periudhës së kontraktuar. Deklarata për cilësinë dhe origjinën e mallrave siguron transparencë dhe gjurmueshmëri të produkteve të furnizuara, duke garantuar se ato janë të standardeve të pranueshme në treg dhe jo produkte të ricikluara apo jashtë specifikimeve.*

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/ distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë:

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) të përditësuar. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), të përditësuar. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:

ISO 9001- 2015 - Certifikate e cilësisë se punimeve Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobilieve për nxënësit e arsimit parauniversitar me qëllim furnizimin me pajisje cilësorë nisur nga fakti që bëhet fjalë për institucione arsimore dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

ISO 45001-2018 - Certifikatë për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndetit Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe operatorët ekonomikë në këtë fushë duhet të zotërojnë një numër të lartë makinerish dhe duhet të kenë të punësuar kryesisht një numër të lartë punonjësish vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

2.4.4 Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/ artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë:

a. Dokumentin që vërteton lidhjen midis prodhuesit ose distributorit. Në rastin e paraqitjes së dokumentit që tregon lidhjen midis ofertuesit dhe distributorit, OE duhet të paraqes dokumentet e lidhjes midis distributorit dhe prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit si: telefon/ fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: kërkesa për paraqitjen e dokumentit që vërteton lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose distributorit është e justifikuar juridikisht dhe teknikisht. Në përputhje me nenin 44, pika 5, të VKM nr. 285/2021, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë dokumentacion që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për furnizimin e mallrave që janë objekt i kontratës. Nëse operatori nuk është vetë prodhuesi, ky dokument siguron gjurmueshmëri dhe garanci për origjinën e pajisjes, autenticitetin e markës dhe përgjegjësinë teknike të prodhuesit në rast të defekteve apo mosfunksionimeve. Në këtë kuptim, kërkesa që dokumenti të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit (emër, adresë, kontakt, faqe interneti etj.) është e domosdoshme për të përmbushur kriterin e transparencës dhe për të mundësuar verifikimin zyrtar të marrëdhënies tregtare ndërmjet palëve. Kjo kërkesë nuk kufizon konkurrencën, por përkundrazi, ndihmon në parandalimin e abuzimeve, si rastet e furnizimit me produkte jo origjinale, të paautorizuara ose jashtë garancisë së prodhuesit.

Prandaj, vendosja e këtij kriteri është ligjërish e bazuar, teknikisht e arsyeshme dhe në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme në procedurat e prokurimit publik.

b. Katalogë / broshura / foto ilustruese ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, për pajisjet e kërkuara duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga pajisjet e ofruara me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse pajisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës për pajisjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që me paraqitjen e katalogut të bëhet i mundur një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara, për të përmbushur kontratën Autoriteti kontraktor synon verifikim e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë ofertues me ato të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë...” broshurës për pajisjet nëse nuk janë në gjuhën shqipe duhet të paraqiten të përkthyer dhe noterizuara.*

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III “Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:

*“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi. Specifikimet teknike të përcaktuara për objektin “FV Mobilieri dhe pajisje në ambientet e brendshme të MZSH” janë hartuar me qëllim që të sigurojnë mobilimin funksional, të qëndrueshëm dhe estetik të ambienteve të institucionit, në përputhje me nevojat e përdorimit të përditshëm dhe standardet bashkëkohore të mobilimit

administrativ. Gjithashtu, përmasat dhe karakteristikat e secilës pajisje (dollapë, tavolina, rafte, krevate, guzhina etj.) janë vendosur në përputhje me standardet ergonomike dhe hapësirat ekzistuese të punës dhe akomodimit, duke garantuar funksionalitet dhe komoditet për përdoruesit. Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e nevojave funksionale të MZSH-së dhe parimeve të konkurrencës së ndershme. Këto specifikime nuk kufizojnë konkurrencën, por vendosin kërkesa minimale objektive, të cilat garantojnë që pajisjet e blera të jenë të sigurta, të certifikuara dhe me performancë të provuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar për prokurimin publik dhe standardet teknike të Bashkimit Europian. Kujdes! Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit